



Më datë 30.07.2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit u hodh shorti për zëvendësimin e gjyqtarit Ardian Hajdari, i caktuar anëtar në çështjen (JR) nr. 76/2021, datë 02.12.2021, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Lorenc Mërkuri kundër vendimit nr. 450, datë 22.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Zëvendësimi i gjyqtarit Ardian Hajdari është bërë për shkak të pezullimit të tij nga detyra me vendimin nr. 13, datë 07.02.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Pas hedhjes së shortit, për caktimin e gjyqtarit anëtar trupi gjykues i çështjes (JR) nr. 76/2021, datë 02.12.2021, do të ketë përbërjen që vijon:

**Kryesuese:** Ina Rama

**Relatore:** Albana Shtylla

**Anëtarë:** Sokol Çomo, Natasha Mulaj, Rezarta Schuetz

